

Shmangia e luhatjes të yndyrës së qumështit gjatë sezonit të verës



Përmbajtja e yndyrës së qumështit është një pasqyrim i mënyrës të ushqyerit, i cili ndikohet edhe nga mënyra e mbarështimit dhe gjenetika. Në stinën e nxehtë të vitit përmbajtja e yndyrës në qumësht shpesh është më e ulët se sa në stinën e dimrit.

Arsyeja kryesore për këtë është stresi i shkaktuar nga i nxehti, i cili çon në çrregullime në mënyrën e të ushqyerit. Gjithashtu edhe ndryshimi i ushqimit voluminoz p.sh dalja në kullota, ushqimi i nxehtë në silos ose koncentratet e skaduara çojnë në luhatje të yndyrës të qumështit. Për këtë, jo vetëm arsyet e mësipërme, por edhe sëmundjet metabolike dhe problemet me/ndaj parazitëve, sëmundjet e thundrave ose sëmundjet e gjirit ulin sasinë e yndyrës në qumësht.

Rumeni duhet të punojë gjatë gjithë kohës

Përgjegjës për formimin e yndyrës së qumështit te gjiri i lopës është acidi acetik, i cili formohet në rumen si dhe në një masë e vogël ndikon edhe acidi butirik. Acidi acetik formohet kryesisht gjatë fermentimit të substancave bimore nëpërmjet mikrobeve që ndodhen në rumen. Për këtë arsye është e rëndësishme dhënia e foragjerëve të tretshëm, por gjithashtu shumë i rëndësishëm është edhe raporti midis ushqimit voluminoz edhe koncentratit si dhe sasia e konsumit total të ushqimit. Bakteriet e acidi acetik kërkojnë një vlerë optimale mbi 6,2 të pH të rumenit. Konsumimi i sa më pak ushqimi voluminoz dhe sa më shumë koncentrat, redukton formimin e pështymës, gjithashtu ul edhe vlerën e pH në rumen. Një racion i grirë imët në mishelator (humbje strukture) ose një ushqim voluminoz në një fazë të re vegetative, i cili ka shumë pak strukturë fizike, çon në një mbi-acidifikim të rumenit. Ndikim ka edhe përbërja e koncentratit. Një sasi e madhe e amidonit dhe sheqernave, të cilat shpërbëhen shpejt në

rumen, kanë një ndikim negativ në sasinë e yndyrës të qumështit. Këtu përfshihen elbi, gruri, triticalet, thekra. Ndërsa panxhari i sheqerit dhe misri janë më të shëndetshme për rumenin, pasi ato fermentohen më ngadalë.

Masat për përmirësimin e sasisë të yndyrës të qumështit:

- Mundohuni që të ketë gjithmonë sasi të mjaftueshme ushqimi. Pastrojeni gjithmonë grazhdin e ushqimit para se të hidhni ushqimin e freskët. Ushqimin voluminoz hidhni disa herë në ditë.
- Shpërndajeni ushqimin për periudha të gjata kohore. Mos e ndryshoni çdo ditë përzierjen e ushqimit. Duhet të tregoni kujdes të veçantë në rastet kur ushqimi merret nga silazhi i bërë në topa plasmasi ose në rastet kur i mbani në kullota.
- Në racionet ushqimore mund të përzieni sasi të vogla kashte (0,5 kg për kafshë) ose sanë. Por sanën mund hidhni edhe ekstra në sasi të vogla.
- Shmangni selektimin e ushqimit. Racioni i përzierë në mishelator duhet të jetë i grirë imët dhe i përzierë mirë. Nuk duhet të jetë shumë i thatë. Shtoni ujë në përzierjen e racioneve të thata me koncentratin.
- Sigurohuni që të ketë furnizim të vazhdueshëm me ujë.
- Kushtojini vëmendje higjenës së ushqimit. Tek gropa e silazhit duhet të merrni ushqim mjaftueshëm, në mënyrë që të mos nxehtet. Në mishelator mund të përzjehen edhe acidifikues në mënyrë që të bëjnë stabilizimin e ushqimit.
- Kontrolloni sasinë e koncentratit të ushqimi voluminoz. Mos e tejkaloni sasinë e tij prej 40% të racionit total. Sasia do të ishte 10 kg për lopët pas laktacionit të dytë ose 9 kg të lopët e laktacionit të parë. Mund të përdorni edhe ushqime të tjera të koncentruara si p.sh bërsia e birrës.
- Në fillim të laktacionit rriteni në sasi të vogla ushqimin e koncentruar, në mënyrë që pas javës së 4 deri në atë të 6 ju të mund të hidhni sasinë maksimale.
- Përdorni ushqime të cilat janë të shëndetshme për rumenin e lopës si misri, panxhari i sheqerit ndoshta edhe krunde.
- Mos përdorni produkte me përmbajtje të lartë yndyrore të tilla si koplzë, kunguj. Përmbajtja e yndyrës prej më shumë se 5% të masës të thatë zvogëlon përmbajtjen e yndyrës të qumështit.
- Ndajeni koncentratit në porcione të vogla. Për të shmangur stresin të kafshët, përdorni një transportues me kapacitet maksimal për 30 lopë.
- Furnizojini mjaftueshëm me lëndë minerale, pasi për shkak të djersitjes ato kanë nevojë për lëndë minerale dhe mikroelementë. Ushqimin me minerale përdoreni me maja të gjallë, pasi ato shpërbëjnë sheqernat në rumen.
- Jepni tretësirë puferike biokarbonat natriumi në vend të kripës (NaCl). Shtoni sasinë e bikarbonatit.
- Sigurohuni që të ketë një qarkullim të mjaftueshëm të ajrit në stallë, në mënyrë që lopët të mos rrinë gjatë gjithë kohës në këmbë duke lënduar kështu thundrat. Shmangni stresin ndaj të nxehtit.